



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 26 , Datë 23.05. 2016

**“PËR NJË SHITESË DHE DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK
TË TIRANËS NR.58, DATË 30.12.2015, “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM 2016-2018 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS PËR
VITIN 2016”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “b” e pika 1/1.3, shkronja “c”, nenit 34, pika 6, nenit 40, pika 4, nenit 41, pika 1, shkronja “c”, nenit 54, shkronja “dh” dhe nenit 55, pikat 3 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2016 për “Vetëqeverisjen Vendore”; nenit 39, paragrafi i fundit dhe nenit 44, paragrafi i dytë, shkronja “a” të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); nenit 128, të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); Ligjit nr. 7776, datë 22.12.1993 për “Buxhetin lokal” (i ndryshuar); udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012 për “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”(i ndryshuar); udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave nr.1 datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 56 datë 27.01.2016 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Punëve të Bëndshme, për marrjen e masave parandaluese, si pasojë e situatës emergjente të krijuar nga rrëshqitja e tokës, në njësinë administrative Farkë, Bashkia Tiranë”; shkresës nr.6355/7 datë 22.02.2016 të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 59, datë 30.12.2015 për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore të qytetit të Tiranës” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 58 datë 30.12.2015 për “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016”, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të miratojë një shtesë në pikën 1.1 të vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.58, datë 30.12.2015, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016” në shumën **390,075,653** lekë, të përbërë nga:
 - a- shtesa e fondit të mbartur nga viti 2015, sipas akt-rakordimeve me Degën e Thesarit të Tiranës, në shumën 562,575,653 lekë;
 - b- pakësimi i planit të të ardhurave të vitit 2016, në shumën 172,500,000 lekë;
2. Të miratojë një ndryshim në pikat 1.1 dhe 2.1 të vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.58, datë 30.12.2015, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016” sipas pasqyrës nr.1 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Të miratojë një ndryshim në pikën 2.2 të vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.58, datë 30.12.2015, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e

- buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016” sipas pasqyrës nr.2 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Të miratojë detajimin e shtesës së fondeve të trashëguara nga viti 2015 dhe rishpërndarjen e fondeve për vitin 2016 në zbatim të pikës nr.1, sipas pasqyrës nr.3, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 5. Të miratojë një shtesë në shumën **905,920,578 lekë** të përbërë nga:
 - a- Fondet e mbartura për vitin 2015 nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve janë në shumën 304,536,926 lekë ndërsa fondet e akorduara për vitin 2016 në programin e Menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik janë në shumën 461,613,572 lekë, detajuar sipas pasqyrës nr.4.1 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - b- Fondet e akorduara për vitin 2016 nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve në programin e Arsimit janë në shumën 109,746,629 lekë, detajuar sipas pasqyrës nr.4.1 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - c- Fondet e akorduara nga Ministria e Punëve të Brendshme si pasojë e situatës emergjente të krijuar nga rrëshqitja e tokës në Njësinë Administrative Farkë, në shumën 30,023,451 lekë, detajuar sipas pasqyrës nr. 4.2 dhe 4.2/1 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 6. Të miratojë detajimin dhe rishpërndarjen e fondeve për objektin “Ndërhyrje emergjente dhe rehabilituese për rrëshqitjen e tokës në zonën e Selitës pranë Xhamisë Farkë “nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, në zbatim të pikës 5/c sipas pasqyrave nr.4.2 dhe 4.2/1 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 7. Të miratojë detajimin dhe rishpërndarjen e fondeve për objektet e reja të vitit 2016 nga FZHR në programin e Menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik dhe programin e Shërbimeve Publike Vendore, nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës, në zbatim të pikës 5/a sipas pasqyrës nr. 4.3 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 8. Në zbatim të pikës nr.4, të miratojë ndryshimet në planin e shpenzimeve kapitale në Programin e Menaxhim, Planifikim, Administrimit; Programin e Shërbimeve Publike; Programin e Menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik; Programit të Arsimit, Programit të Kujdesit Social dhe Programit të Zhvillimit të Rinisë dhe Sportit, sipas pasqyrave nr.4.4, 4.5, 4.6, 4.7, 4.8, 4.9 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 9. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Përgjithshme e Komunikimit dhe marrëdhënieve me Publikun, Njësitë Administrative dhe të gjitha institucionet dhe ndërmarrjet në varësi të Bashkisë së Tiranës.
 10. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë mbas shpalljes.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI

